

MODEL I NJË KËRKESËPADIE

Durrës , më ____ / ____ / ____

KËRKESË PADI

PADITËS: **Emri Mbiemri**, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit sipas vendbanimit/vendqëndrimit, përfaqësuar në gjykim nga avokati sipas prokurës së posaçme/përgjithshme me referencat përkatëse

I PADITUR: **Organi publik sipas emërtesës**, adresa e saktë e tij sipas selisë së regjistruar. *(Shembull: Inspektorati Shtetëror i Arsimit, me adresë në Tiranë, Rruga e Durrësit, nr.219)*

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ - vendimit nr.____ datë ____ “Për dënimin me gjobë” të nxjerrë nga pala e paditur.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.49/2012 datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 17/a i tij.

Ligji i posaçëm që zgjidh mosmarrëveshjen sipas të drejtës materiale *(Shembull ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë”)*

Kodi i Procedurave Administrative (dispozitat e zbatueshme sipas llojit të paligjshmërisë së pretenduar).

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS

I nderuar z. gjyqtar,

Në pjesën shpjeguese të padisë trajtohen:

- Parashtrimi i rrethanave të çështjes sipas ecurisë në kohë të fakteve të ndodhura, ku shtjellohen në mënyrë të qartë dhe të hollësishme veprimet apo mosveprimet e organit publik palë e paditur të kundërshtuara gjyqësisht.
- Bëhet referim në provat që mbështesin faktet e pretenduara (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.)
- Cìtohen dispozitat ligjore ku referohet paligjshmëria e veprimtarisë së organit publik.

Në pjesën përmblylëse të padisë parashtrohen:

- kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet gjykata (ne përputhje me objektin e padisë);
- mënyra dhe afatet e pretenduara për ekzekutimin e vendimit;
- shpenzimet gjyqësore; sasia dhe kujt subjekti i ngarkohen.

Me respekt,

PADITËS

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

I. Padia si akt procedural në gjykimin administrativ

Akti që vë në lëvizje gjykimin administrativ është padia, kuptimi i së cilës jepet nga neni 31, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, si e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Ndërsa thelbi i padisë është e drejta për akses në gjykatë mbi një të drejtë/interes të ligjshëm të cenuar, materializimi i saj bëhet nëpërmjet aktit shkresor të kërkesës padisë, i cili duhet të përmbajë elementet e nevojshme të kërkuara nga ligji për identifikimin e saktë të natyrës së mosmarrëveshjes që shtrohet për diskutim para gjykatës. Neni 153 i K.Pr.Civile përcakton se *“Gjykimi i një çështje në gjykatë, fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim”*. Për qëllime saktësie, duhet theksuar se termi “padi” i referohet të drejtës subjektive (me natyrë procedurale), që gëzojnë subjekti që vë në lëvizje gjykimin administrativ dhe që shndërrohet në palë paditëse. Pra, në këtë kuptim bëhet fjalë për një të drejtë me natyrë materiale. Ky koncept është i ndryshëm nga ai i “kërkesëpadisë”, që i referohet dokumentit me të gjitha ekstremitetet formale ligjore. Në punën e përditshme ndodh rëndom që praktikantët e së drejtës, kërkesëpadisë i referohen me termin padi. Për qëllime të këtij Manuali është e rëndësishme të bëhet një diferencë e tillë, jo vetëm për saktësi profesionale, por edhe për të lehtësuar edhe kuptimin e shkeljeve eventuale dhe pasojave që vijnë prej këtyre shkeljeve.

Në këtë pjesë të Manualit jepen njohuri mbi:

1. elementet e nevojshme të kërkesëpadisë sipas K.Pr.Civile;
2. elementet e posaçme të kërkesëpadisë sipas LGJA;
3. elementet e nevojshëm të kërkesëpadisë jashtë përmbajtjes së saj dhe
4. afatit si kusht formal për depozitimin e kërkesëpadisë, duke përfshirë edhe mënyrat e llogaritjes së tij sipas situatave të paraqitjes së kërkesës padisë.

1.1 Elementët e nevojshëm të kërkesëpadisë sipas K.Pr.Civile

LGJA, në nenin 21, pika 1 të tij parashikon se padia lidhur me një mosmarrëveshje administrative, duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 e 156 të K.Pr.Civile. Në referim të këtyre dispozitave, kërkesëpadia hartohet në tri pjesë përbërëse të saj.

Pjesa hyrëse në të cilën duhet të gjejnë pasqyrim: (1) identiteti i subjekteve që përfshihen në proces sipas pozicionimit procedural që i jep paditësi dhe adresa e saktë e tyre; (2) objekti i padisë, që përbëhet nga një apo disa kërkitime të lidhura midis tyre; (3) baza ligjore e cila përbën tërësinë e dispozitave të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete; dhe (4) gjykata përpara së cilës paraqitet kërkesëpadia.

Të dhënat mbi subjektet procedurale (padiës, i paditur, person i tretë) janë të mjaftueshme për identifikimin e tyre, për aq sa ligji i kërkon, pa qenë e nevojshme pasqyrimi i të gjithë përbërësve gjendjes civile (p.sh. amësia, gjendja civile, apo arsimi përkatës). Kjo për faktin se të dhënat në kërkesëpadi i shërbejnë identifikimit të subjektit që ngre mosmarrëveshjen dhe identifikimit të adresës së banimit apo vendqëndrimit të tij, për qëllime të njoftimit nga gjykata. Në funksion të argumentit të mësipërm, ka shumë rëndësi që kërkesëpadia të shoqërohet me një kopje të letërnjoftimit të padiësit person fizik ose me një ekstrakt i QKB-së kur padiësi është person juridik tregtar.

Pjesa shpjeguese në të cilën duhet të gjejnë pasqyrim: (1) faktet dhe rrethanat që lidhen me mosmarrëveshjen, në kronologji kohore të ndodhjes së tyre; (2) referimi në provat që shoqërojnë kërkesëpadinë, e në çdo rast në ato që konsiderohen kryesore për zgjidhjen e

mosmarrëveshjes (dokumente apo mjete të tjera provuese); si dhe (3) gërshetimi i pretendimeve të subjektit me parashikimet ligjore ku ato gjejnë mbështetje.

Pjesa përmbyllëse në të cilën pala paditëse duhet të artikulojë në sinkron me objektin e padisë, natyrën e kërtimeve të pretenduara nga gjykata, nënshkrimin e tij dhe datën e hartimit të padisë. Kërkesëpadia mund të hartohet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit paditës (avokati, përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik, kujdestari apo prindi nëse paditësi është i mitur), i cili nënshkruan aktin e kërkesëpadisë mbi legjitimitimin nga ligji apo akti i përfaqësimit . Për këtë arsye, neni 156 I K.Pr.Civile, kërkon që bashkë me kërkesëpadinë të paraqitet edhe prokura, në rast se ajo paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij (shkronja “a” e dispozitës). Të metat e kërkesëpadisë, që vënë në dyshim legjitimitetin e paditësit (mungesa e nënshkrimit, nënshkrimi nga një person tjetër i paautorizuar apo mungesa e konfirmimit të përfaqësuesit, kur paditësi nuk ka zotësi të plotë për të vepruar), shkaktojnë pavlefshmëri të saj dhe të gjykimit, nëse ato nuk janë vlerësuar dhe riparuar gjatë gjykimit.

1.2 Elementët e posaçëm të kërkesëpadisë sipas LGJA

Neni 21 i LGJA, ka parashikuar disa elemente formale të kërkesëpadisë tej atyre që jepen nga neni 154 i K.Pr.Civile për qëllime garantuese të njoftimit efektiv të subjektit paditës. Pika 1 e kësaj dispozite kërkon:

1

Të treguarit saktë të adresës së paditësit të përfaqësuesit, në të cilën duhet t’i dërgohen

nga gjykata njoftimet dhe aktet

Ky rregullim përforcues mbi rëndësinë e adresës së saktë, ku paditësi/përfaqësuesi kontaktohet, lidhet me garancitë për ecurinë e gjykimit administrativ pa vonesa nga mosrealizimi i njoftimeve, pasi gjykimi administrativ bazohet në parimin e procesit të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Në funksion të këtij parimi, pika 5 e nenit 21 të LGJA, shprehet se: *“Paditësi, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës, numrit të telefonit dhe adresës elektronike të tij ose të përfaqësuesit, detyrohet të njoftojë gjykatën”*. Ky përcaktim detyrues e vendos paditësin që e shkel atë në pozita të papranueshmërisë së pretendimeve për pavlefshmërinë e njoftimit në adresën e mëparshme.

2

Mënyrat alternative të njoftimit të paditësit

Paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike. Në interpretim jo vetëm literal të dispozitës, kontakti telefonik dhe nëpërmjet adresës elektronike, i kërkohen paditësit për të mundësuar njoftimin e tij edhe në këto mënyra si garanci për marrjen dijeni, por në kushtet kur personat nuk janë të detyruar të kenë të tilla mjete kontakti, paraqet rëndësi fakti që, nëse paditësi zgjedh t’i japë ato, duhet t’i shoqërojë me deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike.

Në pjesën shpjeguese të kërkesëpadisë, paditësi, është i detyruar të identifikojë saktë veprimin ose mosveprimin administrativ që kundërshton për të sqaruar gjykatën për atë

pjesë të veprimtarisë administrative të organit publik të paditur, të cilës i atribuohet paligjshmëria e pretenduar dhe që fokuson objektin e shqyrtimit gjyqësor. Për ilustrim, nëse paditësi është ngarkuar me një detyrim fiskal, veprimi administrativ që kundërshtohet është akti administrativ që ka përcaktuar detyrimin (njoftim vlerësimi i organit tatimor ku paditësi është regjistruar si tatimpagues, apo vendimi i dënimit me gjobë i organit inspektues për fushën e veprimtarisë së ushtruar nga paditësi), nëse paditësi pretendon se nga mosveprimet e organit publik atij i është shkaktuar dëm, mosveprimi administrativ është sjellja e munguar e autoritetit publik, pasojë e së cilës është dëmi jashtëkontraktor etj.

1.3 Elementët e nevojshëm të kërkesëpadisë jashtë përmbajtjes së saj si akt

1.3.1 Aktet e nevojshme në shoqërim të padisë (provat)

Kërkesëpadija është e shqyrtueshme kur ajo është e plotë në elementet e saj formale dhe shoqërohet nga aktet provuese që në kohën e depozitimit të saj. Ky rregull është i përgjithshëm për gjykimin civil sipas parashikimit në nenin 156/b të K.Pr.Civile, i lidhur me përcaktimin parimor në nenin 12 të K.Pr.Civile, për shkak se në konfliktet e natyrës private (civile), barra e provës i takon pretenduesit.

Në gjykimin administrativ, mbizotëron rregullimi sipas ligjit specifik, LGJA, i cili në nenin 21, pika 2 të tij përcakton shprehimisht se: *“Paditësi, përveç aktit administrativ që kundërshton, nuk ka detyrim t’i bashkëlidhë padisë akte provuese, por, nëse i paraqet ato, duhet të paraqesë edhe kopje të tyre për të paditurin”*. Duke qenë se objekt i gjyimit administrativ është paligjshmëria e pretenduar e organit publik në kuadër të ushtrimit prej tij të veprimtarisë administrative, barra e provës për bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej organit publik i takon këtij të fundit. Për shkak të barrës së provës tek organi publik, paditësi ka të drejtë të investojë gjykatën duke paraqitur vetëm aktin administrativ që kundërshton, por mosparaqitja e këtij të fundit e lë padinë me të meta.

Vlen të sqarohet në këtë aspekt të analizës së kërkesëpadisë se përcaktimi i mësipërm nuk është kategorik, në kuptimin që paditësi të justifikohet të mos paraqesë asnjë provë shkrese në gjykatë. Barra e provës bie mbi organin publik që ky i fundit të provojë ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet dhe jo të provuarit e fakteve të ndodhura.

Shembull: Nëse paditësi është liruar nga detyra në një sektor të shërbimit publik, i takon punëdhënësit të paraqesë prova që justifikojnë ligjërisht veprimin e lirit nga detyra (të provuarit mbi sjelljen e ligjshme të punëdhënësit), por nëse paditësi pretendon se marrëdhënia e punës ka zgjatur 8 vjet, (të provuarit mbi faktet) detyrimi për paraqitjen e librezës së punës, apo vërtetimit që provon vjetërsinë në shërbim, i takon paditësit. Gjithashtu, neni 35, pikat 1 dhe 3 të LGJA parashikojnë se barra e provës i bie organit publik kur veprimi administrativ është nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, në të kundërt ky i fundit ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e tij.

Shembull: Nëse ndaj paditësit është ushtruar kontroll mbi cilësinë e karburantit të tregtuar nga ISHTI dhe ka një vendim dënimi me gjobë, barra e provës i takon organit publik, por nëse paditësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe kjo është refuzuar, barra e provës për paligjshmërinë e vendimarrjes të organit publik i takon paditësit.

1.3.2 Tarifa e ngritjes së padisë

Çështja e tarifës gjyqësore është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese e lidhur me procesin e rregullt ligjor në drejtim të aksesit në drejtësi. Kjo Gjykatë ka arsyetuar se duhet dalluar koncepti

i taksës, si një detyrim financiar që duhet paguar nga të gjithë individët, nga ai i tarifës së shërbimit, që në rastin konkret është një detyrim financiar, i cili paguhet në këmbim të një shërbimi në fushën gjyqësore. Gjykata Kushtetuese ka evidentuar se edhe GJEDNJ, asnjëherë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar. Në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte. Në disa çështje konkrete, në lidhje me pagesën paraprake të tarifave gjyqësore, GJEDNJ-ja ka marrë parasysh mundësinë financiare të aplikantit për të paguar tarifën dhe fazën e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës është i detyruar të parapaguajë taksën mbi aktet, e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit. Nga ana tjetër, ligji nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse. Në këtë rast, tarifa gjyqësore nuk pengon aksesin në drejtësi, pasi i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore. Tarifa si element i kërkesëpadisë përcaktohet në varësi të objektit të padisë dhe përfaqëson pagimin ndaj shërbimit gjyqësor që i ofrohet personave fizikë dhe juridikë.

Shembull: Nëse objekt i padisë është shfuqizimi i një akti administrativ (vendim për revokim të lejes për aktivitet minerar) tarifa për gjykim është në masën fikse 3.000 lekë, ndërsa nëse objekti i padisë është shpërblim dëmi jashtëkontraktor, tarifa për gjykim është në masën 1% të vlerës së dëmit të pretenduar, nëse kjo vlerë kalon shumë 300.000 lekë. Sipas pikës 3 të Udhëzimit nr. 33/2014, tarifatat paguhet në momentin e kryerjes së veprimeve dhe bëhen me anën e pullës për tarifatat fikse ose me mandat-arkëtim për ato raste kur, kjo tarifë sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur udhëzimit, është shprehur në përqindje. Një model mbi mënyrën e hartimit të kërkesëpadisë dhe të elementeve të nevojshme të saj, gjendet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

1.4 Afati si kusht formal për depozitimin e kërkesëpadisë dhe llogaritja e tij
E drejta e ushtrimit të padisë, në gjykimin administrativ, kushtëzohet në afat për paraqitjen e kërkesëpadisë në gjykatë, rregullimin e përgjithshëm për të cilin e bën neni 18 i LGJA, pika 1 e të cilit thotë se padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Fillimi i afatit varet nga rregullimi sipas ligjit të posaçëm i shterimit të ankimit administrativ apo nga sjellja

e organit publik të paditur. Disa prej situatave të përcaktuara në nenin 18 të LGJA dhe që hasen në më të shumtën e rasteve të praktikës gjyqësore, referohen si më poshtë:

1

afati i paraqitjes së padisë fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ. Për ilustrim, afati i padisë kundër vendimit të dënimeve administrative të Degëve Rajonale të ISHMP-ve fillon nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit të Ankimit pranë ISHMP në Ministrinë e Mjedisit.

2

afati i paraqitjes së padisë fillon data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë. Për ilustrim, padia kundër vendimit për prishje të objektit ndërtimor nga IMT, njësia vendore pranë Bashkisë së Tiranës, fillon nga data e njoftimit të vendimit.

3

afati i paraqitjes së padisë fillon nga data e njoftimit, data e marrjes së dijenisë për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit. Për ilustrim, padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga shpronësimi në fakt, fillon nga koha e identifikimit të veprimit të paligjshëm të organit publik që kryen veprimin etj. Theksojmë se afati 45 ditor zbatohet kur ligji i posaçëm nuk parashikon ndonjë afat tjetër. **Shembull:** Afati për paraqitjen e padisë në gjykatë të autoritetit rajonal tatimor ndaj Drejtorisë së Apelimit Tatimor është brenda 30 ditëve nga marrja dijani për vendimin e kësaj Drejtorie. Po kështu, afati për paraqitjen e padisë në gjykatë ndaj vendimit të IKMTsë është brenda 10 ditëve nga marrja dijani për të.

Afati i paraqitjes së padisë është kusht formal i saj, mosrespektimi i të cilit passjell vendimin egjykatës për mospranimin e padisë sipas nenit 39, pika 2 të LGJA, pra, nëse padia paraqitet jashtë afatit, gjykata merr vendim të natyrës jopërfundimtare, pasi nuk i hyn shqyrtimit në themel të saj. Mos mbajtja parasyshe e rëndësisë të afatit të paraqitjes së padisë dhe si rrjedhojë paraqitja e padisë me vonesë përpara gjykatës i kushton paditësit vetë aksesin në gjykatë.